



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.03.2022

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të organizatave jo-qeveritare të regjistruara në Republikën e Kosovës.

1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Fushë-Kosovës u bën thirrje të gjitha OJQ-ve të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprimtarinë e vet e zhvillojnë në komunën e Fushë-Kosovës, të aplikojnë për mbështetje financiare për projekt-propozime.

1.1. Shuma minimale e mbështetjes financiare është 500.^{00€}, ndërsa shuma maksimale për një projekt është 4,000.^{00€}.

2. Në përputhje me këtë thirrje publike, OJQ-të mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në:

- **Promovimi dhe përkrahja e aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me përmirësimin e gjendjes shëndetësore dhe sociale të familjeve dhe individëve që kanë nevojë për përkrahje .**
- **Lehtësimin e gjendjes së kategorive të personave me nevoja të veçanta :**
- **Ofrimi i shërbimeve dhe mbrojtja e kategorive të personave në nevojë të cilët janë të organizuar në shoqata të ndryshme:**

3. Numri i OJQ-ve që do të përkrahen është i kufizuar me limitin buxhetor të mjeteve financiare në dispozicion për shpenzim në kategorinë e subvencioneve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

4. OJQ-të mund të aplikojnë me më së shumti një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërin nga fushat prioritare sipas thirrjes;

4.1. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një ditë dhe maksimumi gjashtë muaj.

4.2. OJQ-të duhet të kenë të kryera transaksionet financiare sipas legjislacionit në fuqi në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë të përmbushura detyrimet ndaj Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike;

5. Të drejtë aplikimi për projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-qeveritare në Republikën e Kosovës dhe të cilat veprojnë në komunën e Fushë-Kosovës para datës së publikimit të thirrjes publike.

6. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularin e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim, që do të jetë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare në ueb-faqen e Komunës, linku <https://kk.rks-gov.net/fushekosove/>,

7. Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në mënyrë fizike në adresën e komunës rruga 'Tahir Zemaj' në Zyrën pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e komunës dhe on-line në adresën: hysen.sllamniku@rks-gov.net. Çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrën elektronike në e-mail-adresën e cekur më lartë.

Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetje financiare është pesëmbëdhjetë ditë pune dhe fillon nga data **02.03.2022 dhe përfundon me datë:16.03.2022.**

Vërejtje: OJQ-të dhe personat fizik, përfitues të mbështetjes financiare, 15 ditë pas përfundimit të projektit obligohen të dorëzojnë raportin narrativ dhe financiar me dëshmi të faturave të rregullta me kupon fiskal, dëshmitë e pagesës, pagave dhe kontributeve.

Aplikimet (dokumentacionet) e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen nga Komisioni Vlerësues.

Dokumentet e thirrjes publike

1. Formulari i projekt-propozimit (i plotësuar në mënyrë elektronike)
2. Formulari i propozim buxhetit (i plotësuar në mënyrë elektronike)
3. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së (e skanuar)
4. Kopja e certifikatës të numrit fiskal (e skanuar)
5. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit –OJQ-së (e skanuar)
6. Vërtetimi i Administratës Tatimore i OJQ-së (e skanuar)

